

Hyrje

Letra drejtuar Efesianëve duhet lexuar me kujdes nga të gjithë kristianët sot. Vëmë re se jemi në mes të një krize identiteti, sidomos përsa i përket çështjes së kuptimit dhe të vlerësimit të natyrës së kishës dhe të veçantisë së thirrjes tonë në Krisht. Pothuajse gjysma e anëtarëve të kishës sot nuk e vlerësojnë shumë kishën. Statistikat tregojnë se 81 përqind e amerikanëve besojnë se mund të jenë fetarë, edhe pa qenë anëtarë të ndonjë bashkësie lokale kristianësh (kisha lokale). Kisha nuk është element i jetës së tyre dhe ata nuk shohin ndonjë problem në këtë pikpamje. Ky qëndrim ka hyrë dalëngadalë edhe në mendjet e shumë kristianëve dhe, si rrjedhim, ata nuk e shikojnë kishën e Zotit në shkëlqimin dhe lavdinë e saj.

Një arsye tjetër, se pse i duhet kushtuar kujdes Efesianëve, është se shumë bashkësi të kishës së Zotit kanë më shumë karakterin e një organizate njerëzore se sa atë të kishës së vërtetë, ku Perëndia adhurohet dhe Fjala e Tij është ligj absolut për të gjithë anëtarët. Mungon pikëpamja e Perëndisë për kishën. Në vend që ta kërkojnë në Bibël modelin e Perëndisë për kishën, disa janë përpjekur që t'i japin kishës një formë të zgjedhur nga ata vetë. Kisha është kthyer në një institucion me një qëllim dhe një mision të kushtëzuar gjithnjë e më shumë nga «nevojat» në rritje të një shoqërie që e ka hedhur poshtë fenë. Është ironike që, edhe pse kisha bën aq shumë përpjekje për t'u shërbyer njerëzve, për t'i tërhequr drejt Perëndisë, njerëzit

prapë se prapë nuk e vendosin kishën shumë lart në listën e tyre të përparësive.

Sigurisht, jo të gjithë kristianët e kanë humbur vlerësimin dhe dashurinë për kishën. Jo të gjitha bashkësitë e kishës së Zotit i janë përshtatur mënyrës laike të të menduarit. Jo të gjitha kishat e kanë humbur veçantinë e tyre, por të gjithë kristianët dhe të gjitha bashkësitë ballafaqohen me rrezikun e humbjes së fokusit dhe qëllimit që ka Perëndia për kishën dhe njerëzit e Tij. Efesianëve na kujton se kisha është *njerëz*, njerëz të shpëtuar. Kisha është krijesa e re e Perëndisë. Letra drejtuar Efesianëve pohon lavdinë e kësaj. Ajo përmban përshkrimin që i bëri Pali natyrës së kishës, kësaj krijese të re dhe të mrekullueshme. Ai po u bënte thirrje kristianëve për të jetuar si krijesa e re, e krijuar nga Perëndia nëpërmjet Krishtit.

Sa herë që lexojmë një letër të Dhjatës së Re, duhet t'u përgjigjemi pesë pyetjeve bazë: (1) Kush e shkroi letrën? (2) Për kë u shkrua letra? (3) Kur u shkrua? (4) Pse u shkrua? (5) Cili është mesazhi kryesor? Para se të fillojmë studimin e letrës drejtuar Efesianëve si dhe të mësimëve që gjenden aty për kishën, krijesën e re të Perëndisë, duhet t'u përgjigjemi pesë pyetjeve të mësipërme.

AUTORI I LETRËS

Vargu i parë i Efesianëve na tregon për autorin: «Pali, apostulli i Jezu Krishtit me anë të vullnetit të Perëndisë, shenjtorëve që janë në Efes dhe be-

simtarëve në Jezu Krishtin: Hir dhe paqe qoftë mbi ju prej Perëndisë, Ati ynë, dhe nga Zoti Jezu Krisht» (1:1–2). Ishte praktikë normale në shekullin e parë që shkrimtarët t'i fillonin letrat duke treguar se kush ishin. Pali ndoqi të njëjtën praktikë.

Pali, gjithashtu, tha se kishte një titull që Jezusi u dha të dymbëdhjetëve (Luka 6:12–13). Ai ishte «apostull» (nga greqishtja – *apostolos*), person që është zgjedhur në mënyrë të veçantë dhe është dërguar për të bërë të njohur një mesazh të rëndësishëm. Ajo që shkroi Pali ishte e autorizuar. Ishte më shumë se thjesht opinionet, idetë apo sugjerimet e vetë Palit. Mesazhi i tij nuk e kishte burimin te Pali. Mesazhi i ishte dhënë Palit nga Jezu Krishti. Ato që ai shkroi duhen marrë si fjalët dhe udhëzimet e Zotit Jezu Krisht.

Pali u bën të njohur lexuesve se nuk u bë apostull vullnetarisht. Ai nuk aplikoi për këtë post. Asnjë kishë nuk e caktoi në këtë post. Përkundrazi, ai u bë apostull sipas autoritetit më të madh të mundshëm. Ai u emërua nga Jezu Krishti, sipas vullnetit të Perëndisë, Atit.

Kur lexojmë letrën e Efesianëve, duhet ta shikojmë veten sikur mbajmë në duar një letër të dërguar nga Perëndia. Fjalët që lexojmë nuk janë fjalët e një njeriu të thjeshtë. Ato janë fjalët e Perëndisë. Perëndia na flet nëpërmjet asaj që apostulli Pal shkroi.

KUJT I DREJTOHET LETRA?

Kjo letër u drejtohet «shenjtorëve që janë në Efes dhe besimtarëve në Jezu Krishtin». Vini re se çfarë thotë Pali për lexuesit.

Së pari, ata ishin «shenjtorë» (në greqisht, *agios*). Kjo fjalë nuk përshkruan një klasë të veçantë kristianësh që janë mbi të tjerët. Shenjtorët nuk janë një grup i vogël kristianësh të veçantë, shenjteria e të cilëve është mbi normalen. «Shenjtor» është një emërtim për çdo kristian. Çdo fëmijë i Perëndisë është shenjtor në kuptimin se është veçuar që t'i përkasë Perëndisë. Kjo fjalë është përdorur në fillim për të përshkruar kombin e Izraelit. Izraeli ishte «kombi i shenjtë». Tani fjala përfshin të gjithë njerëzit që i përkasin Perëndisë nëpërmjet Krishtit. Krijesa e re e Perëndisë në Krisht, kisha, është Izraeli (kombi) i vërtetë i Perëndisë (Galatasve 6:16).

Së dyti, ata ishin «besimtarë» (në greqisht, *pistos*). Me fjalë të tjera, Pali u drejtohet atyre

njerëzve që e kanë vendosur besimin e tyre te Zoti Jezu Krisht. Ata, ndryshe nga jobesimtarët, ishin besimtarë në Krisht.

Së treti, ata ishin «në Jezu Krishtin». Kjo fjalë kyçe te Efesianëve gjendet në vargun e parë të kësaj letre. Krijesa e re e Perëndisë ekziston dhe e jeton jetën e saj «në Krishtin». Të jesh «në Krisht» do të thotë të jesh i bashkuar me të, ashtu si degët te trungu i hardhisë apo pjesët e veçanta te trupi. Kristianët e vendosin besimin e tyre në Krishtin dhe përpiqen ta jetojnë jetën e tyre duke treguar besim në Të.

Së fundi, letra u shkrua për ata që ishin «në Efes». Efesi ishte kryeqyteti i provincës romake në Azi dhe ishte një port tregtar shumë i madh dhe i zhurmshëm. Efesi ishte gjithashtu edhe qendra e adhurimit të perëndeshës pagane Diana. Tempulli i ndërtuar në Efes për nder të saj konsiderohet si një nga shtatë mrekullitë e botës së lashtë.

Për herë të parë, Pali shkoi në Efes për një kohë të shkurtër, gjatë udhëtimit të tij të dytë misionar (Veprat 18:18–21). Ai u kthye më vonë dhe qëndroi atje më shumë se dy vjet, gjatë udhëtimit të tij të tretë misionar. Pasi u mësoi njerëzve për tre muaj me radhë në sinagogë, ai u detyrua të shkonte diku tjetër dhe filloi të jepte mësim në shkollën e një farë Tirani (Veprat 19:8–9). Pali e siguronte jetesën duke bërë tenda. Mesazhi i tij u përhap te të gjithë banorët e Azisë (Veprat 19:10). Perëndia bënte mrekulli të jashtëzakonshme me anë të duarve të Palit. Peshqirët dhe përparëset që prekte Pali përdorshin për të shëruar të sëmurët (Veprat 19:11–12). Frymërat e liga ndiqeshin tutje në emër të Jezusit, madje edhe nga yshtësit judenj (Veprat 19:13–16). Shumë kristianë që vinin nga një e kaluar pagane ku praktikoheshin magjia ndaluan së bërë gjëra të tilla dhe dogjën librat e magjisë (Veprat 19:18–20). Në fund, u bë një trazirë kur Dhimitri, një argjendar, akuzoi se suksesi i Palit përbënte një rrezik për ekonominë e qytetit. Predikimi i Palit po dëmtonte tregtinë e atyre që bënin figurina të argjendta të tempullit të Dianës (Veprat 19:23–41). Kjo, si përfundim, çoi në largimin e Palit, por jo para se kisha të themelohej në mënyrë të qëndrueshme.

Pali nuk u kthye më në Efes, por ai u takua me pleqtë e kishës në qytetin e Miletit, kur po kthehej në Jeruzalem. Ai mbajti atje një ligjëratë shumë prekëse lamtumire (Veprat 20:13–38).

Disa kanë sugjeruar se kjo letër duhet konsideruar si një qarkore drejtuar *gjithë* kishave në Azinë e Vogël, jo vetëm kishës në Efes. Në letrën e Efesianëve mungojnë gjithashtu përshëndetjet tipike ndaj individëve të veçantë që Pali do të ketë takuar gjatë qëndrimit të tij në Efes. Në letër nuk përmenden ngjarje të përditshme. Në këtë letër, Pali nuk përmend apo përshëndet persona të veçantë, siç bëjnë në disa nga letrat e tjera të shkruara prej tij. Kjo mund të na bëjë të mendojmë se letra e Efesianëve ishte një qarkore. Megjithatë, përcaktimi gjeografik i vendit ku ndodhej kisha, të cilës i drejtohej letra, nuk e ndryshon mesazhin kryesor të saj. Letra është një mesazh për kishën, njerëzit e zgjedhur të Perëndisë, kudo dhe në çdo kohë.

DATA KUR U SHKRUAR LETRA

Pali përmendi tri herë në letër se po shkruante nga burgu (3:1, 4:1, 6:20). Letra konsiderohet si njëra prej letrave të shkruara nga burgu (Efesianëve, Filipianëve, Kolosianëve dhe Filemonit). Ka arsye të mira për të besuar se vendi ku ishte burgosur Pali ishte Roma (viti 60–62 A.D.). Pali ndenji i burgosur dy vjet në Romë (Veprat 28:16–31). Gjithashtu, që nga fillimi i kishës deri në shek. XVIII, është pranuar se të katër letrat e mësipërme (të quajtura ndryshe edhe letrat e burgut) janë shkruar nga një burg në Romë.

Epafrasi erdhi të shikonte Palin dhe i dha disa lajme shqetësuese për kishën në Kolose. Me sa duket, mësuesit e rremë po e shkatërronin atë kishë, kështu që Pali u shkroi një letër edhe Kolosianëve. Ai gjithashtu i shkroi një letër personale një anëtari të asaj bashkësie të quajtur Filemon. Letra bënte fjalë për një skllav të Filemonit (i cili ishte arratisur më parë), të quajtur Onesim, i cili, pasi i ishte bindur ungjillit, ishte kthyer te i zoti. Gjatë kësaj kohe u shkrua edhe letra e Efesianëve që i drejtohet ose kishës në Efes, ose kishave fqinje në provincën romake të Azisë. Të tria këto letra u dërguan nga «Tikiku, vëllai i dashur» i Palit dhe «shërbenjësi besnik në Zotin» (6:21). Filipianëve, me sa duket, u shkrua në një rast tjetër, gjatë së njëjtës periudhë në burg.

QËLLIMI I LETRËS

Ndërsa lexojmë letrën drejtuar Efesianëve, mund të shikojmë se Pali kishte dy qëllime kryesore në shkrimin e saj. Së pari, Pali donte të shpjegonte

natyrën e kishës, krijesën e re të Perëndisë, duke treguar origjinën e saj, përbërjen e saj prej hebrenjve dhe johebrenjve të shpëtuar si dhe qëllimin e saj të përgjithshëm (kapitujt 1—3). Së dyti, Pali u përpoq t'i bënte thirrje krijesës së re për të mbajtur qëndrimin e duhur (kapitujt 4—6). Qëndrim i duhur do të thotë t'i japësh përparësinë më të madhe unitetit në trupin e Krishtit (4:1–16), të kërkosh të jesh i shenjtë në jetën e përditshme (4:17—6:9) dhe, me maturi, të përgatitesh të mposhtësh rezistencën e Satanit, gjatë gjithë kohës (6:10–20). (Një përmbajtje në vija të përgjithshme e letrës drejtuar Efesianëve jepet në fund të këtij mësimi.)

MESAZHI I LETRËS

Tema kryesore e Efesianëve përmbledhet në këto vargje:

...për të krijuar në vetvete nga dy një njeri të ri, duke bërë paqen, dhe për t'i pajtuar të dy me Perëndinë në një trup të vetëm me anë të kryqit, mbasi vrau armiqtë në vetvete...që nëpërmjet kishës, në kohën e tashme u manifestohej principatave dhe pushteteve, në vendet qiellore, dituria e shumë-llojshme e Perëndisë, sipas qëllimit të përgjithshëm që ai kreu në Krishtin Jezus, Zotin tonë (2:15b–16, 3:10–11).

Mesazhi i saj përqëndrohet në veprimin shpëtues të Perëndisë, nëpërmjet Jezu Krishtit, për të krijuar krijesën e re të Perëndisë në mes të së vjetrës. Letra kombinon teorinë me praktikën. Ajo na mëson se ç'është kisha e Zotit, krijesa e re, dhe jep udhëzime të qarta praktike për jetën e përditshme të kësaj kishë (çdo anëtari të saj).

KONKLUZION

Mendonini se sa rëndësi ka studimi i Efesianëve për kristianët dhe për bashkësitë e kishës së Zotit. Letra e Efesianëve mbetet libri më i mirë për shpjegimin e natyrës dhe rëndësisë së kishës, krijesës së re të Perëndisë. Njerëzit mund ta studiojnë letrën e Efesianëve në tri mënyra:

Disa mund ta lexojnë atë si një letër të shkruar për njerëzit që jetuan shumë kohë më parë dhe, si rrjedhim, nuk e marrin mesazhin që ajo përmban për kristianët sot. Ky lloj studimi i letrës së Efesianëve nuk është asgjë më shumë se studimi i një dokumenti të lashtë që nuk ka asnjë lidhje me ditët e sotme. Në qoftë se e studiojmë letrën në këtë mënyrë, nuk do ta marrim seriozisht mesazhin e

sajdhe madje leximi i saj mund të na bëhet i mërzitshëm.

Të tjerë mund ta lexojnë letrën e Efesianëve si një material që shpjegon teorikisht dhe në përgjithësi natyrën e kishës dhe, si rrjedhim, nuk marrin gjysmën e mesazhit të saj për kristianët sot. Letra e Efesianëve përmban shumë doktrinë (të vërteta të Perëndisë për kishën). Ajo paraqet pak nga e vërteta bazë lidhur me kishën dhe planin e shpëtimit të njeriut prej Perëndisë. Në qoftë se e studiojmë letrën e Efesianëve vetëm si një libër shkollor mbi doktrinën dhe nuk marrim parasysh edhe zbatimet praktike që ajo ofron, do të marrim në këtë mënyrë vetëm

gjysmën e mesazhit të saj. Ky lloj studimi do na bëjë të humbasim një nga qëllimet kryesore të librit që është të ndryshojë jetën tonë, si njerëz që bëjnë pjesë në krijesën e re të Perëndisë.

Le ta lexojmë letrën e Efesianëve si një mesazh nga Perëndia për ne. Kjo është mënyra si Perëndia do që ta studiojmë atë. Ajo është Fjala e Perëndisë. Në qoftë se e studiojmë atë në këtë mënyrë, atëhere ajo do na ndryshojë si njerëz. Kjo është ajo që do Perëndia. Lutem që të ndryshoni pasi ta lexoni dhe ta studioni letrën e Efesianëve ashtu si duhet. Perëndia ju bekoftë ndërsa filloni studimin e kësaj letre të mrekullueshme!

PËRMBAJTJA E LETRËS DREJTUAR EFESIANËVE NË VIJA TË PËRGJITHSHME

HYRJE (1:1–2)

I. LAVDIA E KRIJESËS SË RE TË PERËNDISË (1:3—3:21)

- A. Plani i Perëndisë për shpengimin tonë nëpërmjet Jezu Krishtit (1:3–14)
 - 1. Ati (1:3–6)
 - 2. Biri (1:7–12)
 - 3. Fryma e Shenjtë (1:13–14)
- B. Lutje falënderimi dhe ndërhyrje për të shpenguarit (1:15–23)
 - 1. Falënderim për besimin dhe dashurinë (1:15–16a)
 - 2. Pali lutet për lexuesit e letrës (1:16b–23)
- C. Njerëzit që janë shpëtuar (2:1–22)
 - 1. Mëkatarë që kanë marrë jetë (2:1–10)
 - 2. Judenjta dhe johebrenjtë të bashkuar në Krishtin si një njeri i ri (2:11–22)
- D. Qëllimi i përvetshëm i Perëndisë për të shpëtuarit (3:1–12)
- E. Lutje për forcimin e të shpëtuarve (3:13–21)

II. ECJA E KRIJESËS SË RE TË PERËNDISË (4:1—6:20)

- A. Në unitet (4:1–6)
- B. Me dhunti (4:7–16)
- C. Me shenjtëri (4:17—5:17)
- D. Të mbushur me Frymë (5:18–21)
- E. Detyrat familjare (5:22—6:9)
 - 1. Gratë (5:22–24)
 - 2. Burat (5:25–33)
 - 3. Fëmijët (6:1–3)
 - 4. Prindërit (6:4)
 - 5. Shërbëtorët (6:5–8)
 - 6. Zotërinjtë (6:9)
- F. Në luftë me të keqen (6:10–20)
 - 1. Nevoja për fuqinë dhe armatimin e Perëndisë (6:10–13)
 - 2. Natyra e armatimit të Perëndisë (6:14–17)
 - 3. Nevoja për lutje (6:18–20)

KONKLUZIONI (6:21–24)

Autor: *Rusty Peterman*
Marrë nga seria: “Efesianëve”
© 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara